

BANKA E PARË E INVESTIMEVE - ALBANIA SH.A.

Raporti i audituesit të pavarur dhe
pasqyrat financiare
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	2
Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	4
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	5 - 36

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin dhe Aksionarin e First Investment Bank – Albania Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të First Investment Bank – Albania Sh.a. (më tej referuar si "Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale në përputhje me "Metodologjinë e Raportimit dhe Përmbajtjen e Raportimit Financiar" të aprovuar nga Banka e Shqipërisë në 24 dhjetor 2008 dhe kuadrin rregullator dhe kërkesat e Bankës së Shqipërisë.

Baza për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me nenin 47 të Ligjit për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdijë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë.
- Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare individuale përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.
Tirana, Albania
16 prill 2026

Grant Thornton sh.p.k.



Esmeralda Gjomeno, AL

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
AKTIVET			
Arka dhe Banka Qendrore	5	7,411,824	6,032,758
Hua dhe paradhënie neto për bankat	6	2,826,509	3,244,328
Investime në letra me vlerë	7	24,196,970	17,956,653
Hua dhe paradhënie neto për klientët	8	38,304,220	32,126,551
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	9	558,198	464,959
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	10	207,827	128,790
Aktive të marra në riposedim	11	161,101	183,828
Aktive të tjera	12	132,331	104,540
GJITHSEJ AKTIVET		73,798,980	60,242,407
PASIVET			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	13	4,569,555	2,995,412
Detyrime ndaj klientëve	14	57,748,745	47,780,933
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	15	1,233,112	383,874
Borxhi i varur	16	1,382,238	974,048
Detyrime të tjera	17	1,051,170	1,021,339
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime	18	456,012	435,696
Gjithsej detyrimet		66,440,832	53,591,302
Kapitali i paguar	19	1,516,517	1,516,517
Rezerva ligjore dhe të tjera	19	488,444	463,746
Diferenca e rivlerësimit të kapitalit		(357,738)	(341,213)
Fitime të akumuluar		5,710,925	5,012,055
Kapitali aksioner		7,358,148	6,651,105
GJITHSEJ PASIVET		73,798,980	60,242,407

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 36, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë

	Shënimi	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga interesat		2,257,490	2,205,637
Shpenzime për interesat		(1,101,034)	(861,258)
Të ardhura neto nga interesat	20	1,156,456	1,344,379
Të ardhura neto nga veprimet financiare	21	800,800	719,128
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		898,101	804,342
Shpenzime për tarifat dhe komisionet		(365,380)	(294,321)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	22	532,721	510,021
Të ardhura / (Shpenzime) neto nga veprimtaritë e tjera bankare		(50,961)	(26,636)
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	23	106,439	106,731
Gjithsej të ardhura nga veprimtaria bankare		2,545,455	2,653,623
Shpenzime personeli	24	(623,307)	(568,987)
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat		(6,412)	(5,672)
Shpenzime për shërbime të jashtme	25	(545,032)	(488,109)
Shpenzime te përgjithshme të veprimtarisë		(1,174,751)	(1,062,768)
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	9,10	(78,139)	(68,837)
Ndryshimi në shpenzimet për fondet rezervë për huatë	26	(110,329)	(258,763)
Ndryshimi në fondet rezervë për letrat me vlerë		(5,214)	11,614
Shpenzime për fondet rezervë të tjera		28,251	(23,126)
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme		(177,708)	-
Shpenzimet për fondin rezervë		(265,000)	(270,275)
E ardhura neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme		38,951	4,008
Fitimi i vitit ushtrimor para tatimit mbi të ardhurat		1,066,516	1,255,751
Tatimi mbi fitimin	27	(195,273)	(161,841)
FITIM I VITIT USHTRIMOR		871,243	1,093,910

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 36, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë

		Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale			
Fitim i vitit ushtrimor		871,243	1,093,910
Provizione për humbjet nga kreditë	26	110,329	258,762
Fonde rezervë të tjera		(23,037)	11,512
Amortizimi dhe zhvlerësimi i mjeteve të qëndrueshme	9,10	78,139	68,837
(Fitim) / humbja nga nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve të qëndrueshme		5,425	(621)
(Fitim) / humbja nga shitja e aktiveve të tjera (Fitim) nga marrja në pronësi e kolateraleve për kredi të fshira		45,534	27,869
Efekti i zërave të tjerë të përlogaritur dhe të shtyrë		(1,523)	6,880
(Rritje) në interesat për tu arkëtuar		157,586	(187,708)
Rritje në interesat për tu paguar		79,863	34,876
Ndryshimi në diferencat e rivlerësimit		(28,022)	(67,612)
		1,295,537	1,246,705
Ndryshimi në rezervën e detyruar		(1,179,243)	(634,574)
Ndryshimi në huatë për bankat		417,698	1,038,683
Ndryshimi në huatë dhe paradhëniet për klientët		(6,481,133)	(4,202,440)
Ndryshimi në mjetet e tjera		(52,308)	52,498
Ndryshimi në depozitat nga bankat		1,568,722	(483,624)
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve		9,897,502	5,643,400
Ndryshimi në detyrime të tjera		62,022	(131,284)
Fluksi neto i arkës nga aktivitetet operacionale		5,528,797	2,529,364
Aktivitetet investuese:			
Blerje e letrave me vlerë		(21,437,458)	(21,415,489)
Shitje/Maturime të letrave me vlerë		15,258,703	19,219,174
Blerje e aktiveve të qëndrueshme	9,10	(255,840)	(147,087)
Fluksi neto i arkës përpara financimit		(905,798)	185,962
Aktivitetet e financimit:			
Rritje e kapitalit të paguar			-
(Rënia) / Rritja në huamarrje		848,911	(23,805)
Emetimi / (ripagim) i borxhit të varur		404,385	(56,727)
Dividentë të paguar		(147,675)	(100,860)
Fluksi neto i arkës nga aktivitetet e financimit		1,105,621	(181,392)
Rritja neto e arkës dhe gjendjeve në bankën qendrore		199,823	4,570
Aktivitet monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		1,414,480	1,409,910
Aktivitet monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	30	1,614,303	1,414,480

Pasqyra e përmbledhur e flukseve së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 36, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
 në mijë Lekë

	<i>Kapitali i paguar</i>	<i>Rezerva</i>	<i>Diferenca e rivlerësimit të kapitalit</i>	<i>Fitimet e mbartura</i>	<i>Gjithsej</i>
Gjëndja më 1 janar 2024	1,516,517	452,194	(272,598)	4,030,558	5,726,670
Ndryshimi në rivlerësimin e kapitalit	-	-	(68,615)	-	(68,615)
Rezerva ligjore	-	-	-	-	-
Rezerva të tjera	-	11,553	-	(11,553)	-
Fitimi i vitit ushtrimor	-	-	-	1,093,910	1,093,910
Dividentë të paguar	-	-	-	(100,860)	(100,860)
Gjëndja më 31 dhjetor 2024	1,516,517	463,746	(341,213)	5,012,055	6,651,105
Ndryshimi në rivlerësimin e kapitalit	-	-	(16,525)	-	(16,525)
Rezerva ligjore	-	-	-	-	-
Rezerva të tjera	-	24,698	-	(24,698)	-
Fitimi i vitit ushtrimor	-	-	-	871,243	871,243
Dividentë të paguar	-	-	-	(147,675)	(147,675)
Gjëndja më 31 dhjetor 2025	1,516,517	488,444	(357,738)	5,710,925	7,358,148

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 36, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtimi më **27 Mars 2026** dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


 Bozhidar Todorov
 Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv




 Elma Lloja
 CEO & Drejtor Ekzekutiv


 Edvin Lika
 Drejtor i Departamentit të Financës dhe
 Kontabilitetit

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
 në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe

1. Të përgjithshme

Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri (Banka) është themeluar në Republikën e Shqipërisë si shoqëri anonime më 1 gusht 2005 dhe i ka zyrat e saj qendrore në Tiranë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake, Kulla 2.

Banka është e licensuar nga Banka e Shqipërisë (BSh) më 6 korrik 2007, në bazë të së cilës asaj i lejohet të kryejë të gjithë veprimtaritë bankare të lejuara nga legjislati shqiptar. Banka është kryesisht e përfshirë në shërbimet bankare të korporatave dhe atyre retail dhe është e autorizuar të operojë si ndërmjetës në tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Shqipërisë. Banka gjithashtu është licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer shërbimet e depozitarit, kujdestarit dhe brokerimit.

Banka është një filial i Bankës së Parë të Investimeve A.D. (më pas "Mëma"), një entitet i krijuar në Bullgari si institucion financiar e cila zotëron 100% të aksioneve të Bankës. Më parë Banka operonte si një degë e huaj e Mëmës në Shqipëri që nga Shkurti i vitit 1999.

Struktura e aksionarëve të Mëmës më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

Aksionarët	% e kapitalit aksionar 31 dhjetor 2025	% e kapitalit aksionar 31 dhjetor 2024
Z. Ivailo Dimitrov Mutafchiev	31.36	31.36
Z. Tzeko Todorov Minev	31.36	31.36
Banka Bullgare për Zhvillim AD	18.35	18.35
Valea Foundation	7.87	7.87
Aksionarë të tjerë (të cilët kanë aksione të cilat tregtohen në Tregun e Aksioneve në Sofie, Bullgari)	11.06	11.06
Gjithsej	100.00	100.00

Zyrat qendrore të Bankës së Parë të Investimeve - Albania sh.a. ndodhen në Tiranë. Rrjeti i degëve përfshin 16 degë. Pesë degë ndodhen në Tiranë dhe degët e tjera ndodhen në: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Kavajë, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë.

Banka kishte 288 punonjës më 31 dhjetor 2025 (31 dhjetor 2024: 277). Numri mesatar i punonjësve për vitin që mbaron në 31 dhjetor 2025 është 281 (31 dhjetor 2024: 270).

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e Raportimit Financiar" ose MRF të aprovuara nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u aprovuan për qëllime rregullative, në përputhje me nenin 47 të ligjit Nr. 9662, më datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Vijueshmëria

Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e parimit të vijueshmërisë, pasi drejtimi vlerëson që Banka ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme.

Detajet e politikave kontabël të Bankës përfshihen në Shënimin 2.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe

2. Politika të rëndësishme kontabël**a) Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Bankës, shumat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt. Sikurse lejohet edhe nga legjislacioni vendas, kapitali i paguar është rregjistruar në Euro në përputhje me kurset e këmbimit historike në datën e transaksionit, dhe është paraqitur në Lekë si ekuivalent i balancës origjinale të Euros. Në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë, diferenca midis vlerës në Lekë të kapitalit me kursin e këmbimit historik dhe kursit të këmbimit në datën e bilancit rregjistrohet si diferencë rivlerësimi në kapital.

Pasqyrat financiare janë përgatitur me kosto historike dhe politikat kontabël të aplikuara janë të njëjta me ato të aplikuara nga Banka për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.

b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe pasivet monetare të shprehura në monedhë të huaj rikëmbehen në Lekë me kursin e asaj date. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivet dhe pasivet jo monetare që maten me koston historike të një monedhe të huaj, këmbehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

Kurset zyrtare të këmbimit të zbatuara nga Banka (lekë në njësinë e valutës së huaj) për monedhat kryesore të huaja më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2024
Dollari amerikan	82.46	94.26
Euro	96.77	98.15

c) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përbëhen nga balancat në arkë dhe balancat e pakushtëzuara me Bankën Qendrore. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalente me to sipas përkufizimit të mësipërm janë aktivet me likuiditet shumë të lartë dhe me maturitet më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i rreziqeve jo të rëndësishme nga ndryshimi në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e detyrimeve afat-shkurtra.

d) Investime në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim (të investimit)

Letrat me vlerë të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturitet përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të investuara mbarten me koston e amortizuar.

e) Investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje (të vendosjes)

Letrat me vlerë të mbajtura për shitje janë blerë me qëllimin që Banka do t'i mbajë për më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të atyre të cilat Banka ka si qëllim t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat janë klasifikuar sipas rregullave të letrave të investimit. Letrat me vlerë të mbajtura për shitje gjithashtu përfshijnë letra me vlerë të cilat nuk rregjistrohen as si të tregtueshme as si letra me vlerë të investimit.

Letrat me vlerë të mbajtura për shitje fillimisht rregjistrohen me çmimin e blerjes duke përjashtuar kostot. Në çdo datë bilanci krijohen fonde rezervë përkundrejtë humbjeve të kapitalit të përealizuara të cilat vijnë si rezultat i diferencave midis vlerës kontabël dhe çmimit të tregut. Fitimet e kapitalit të përealizuara nuk rregjistrohen.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe
2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)
f) Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve raportohen neto nga provizionet për humbjet specifike nga kreditë për kreditë e klasifikuara si nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura. Provizionet e krijuara për humbje të mundshme për kreditë e klasifikuara si standarte dhe në ndjekje janë klasifikuar si provizion statistikor në pasiv të bilancit kontabël. Politikat e kredidhënies dhe procedurat e Bankës janë në përputhje me instruksionet e Bankës së Shqipërisë. Provizionet krijohen në zbatim të rregullores Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Për Menaxhimin e Rrezikut të Kredisë” (rregullorja e kredisë) e miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës datë 14 shtator 2011. Banka i klasifikon kreditë sipas kategorive të mëposhtme dhe përdor normat e mëposhtme të provizionit për humbjet nga kreditë:

Klasifikimi i kredisë	Ditë vonese për overdraftet	Ditë vonese për huatë me afat	Norma e provizionit për kryegjënë	Norma e provizionit për interesin
Standarde	1-30 ditë	1-30 ditë	1 %	1%
Në ndjekje	31-60 ditë	31-90 ditë	5 %	5%
Nën-standarde	61-90 ditë	91-180 ditë	20 %	100%
Të dyshimta	91-180 ditë	181-365 ditë	50 %	100%
Të humbura	Mbi 180 ditë	Mbi 365 ditë	100 %	100%

Provizioni për humbje nga kreditë

Provizioni është rregjistruar si kundër aktiv ndaj kredive të klientëve në bilancin kontabël. Ky provizion përfshin llogaritje të cilat mbulojnë humbjet e mundshme nga kreditë nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura.

Provizioni për rreziqet dhe shpenzimet

Provizioni për rrezikun statistikor për kreditë dhe garancitë është i bazuar në informacion statistikor të lidhura me humbjet nga kreditë nga kreditë standarte dhe në ndjekje.

g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten në bilanc me koston e blerjes duke zbritur amortizimin e akumuluar. Jeta e përdorimit llogaritet në bazë të pritshmërisë së Drejtimit për jetëgjatësinë e aktivitetit. Amortizimi llogaritet me metodën lineare me normat e parashikuara për të ulur koston e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Vitet e pritshme të përdorimit janë si më poshtë:

Ndërtesa dhe punime në ambjentet e marra me qira	5-50 vite
Paisje dhe instalime	10 vite
Automjete	10 vite
Makineri dhe paisje	10 vite
Kompjutera dhe paisje informatike	5 vite
Aktive të tjera të trupëzuara	10 vite

Aktivet nuk amortizohen derisa ato futen në përdorim dhe transferohen nga aktive në proces në kategorinë përkatëse të aktiveve.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

h) Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivët e qëndrueshme të patrupëzuara paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjen nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet me metodën lineare mbi jetën e përdorimit të aktivit. Jeta e përdorimit është si më poshtë:

Patenta dhe licenca	5 vite
Programe kompjuterike & aktive të tjera të patrupëzuara	5 vite

i) Aktivët e marra në riposedim

Aktivët e marra në riposedim janë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të përfuara nga Banka kundrejt shlyerjes së kredive dhe njihen me vlerën me të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Çdo fitim apo humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit njihet në të ardhura apo shpenzime.

Banka në rastin kur nuk mund të shesë aktivët e marra në riposedim brenda vitit të parë të përfuturit të tyre krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve në zbatim të rregullores Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Për Menaxhimin e Rrezikut të Kredisë” e miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës datë 14 shtator 2011. Fondet rezervë për pasuritë e paluajtshme krijohen mbi vlerën kontabël brenda 7 viteve nga data e marrjes së tyre në pronësi në përfundim të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm për kreditë e pashlyera, sipas normave të parashikuara në rregulloren e kredisë në nivelin jo më pak se norma në përqindje e vlerës kontabël të këtyre pasurive, sipas tabelës së mëposhtme.

Viti i parë	5%
Viti i dytë	10%
Viti i tretë	15%
Viti i katërt	15%
Viti i pestë	15%
Viti i gjashtë	20%
Viti i shtatë	20%
Gjithsej	100%

Për pasuritë e luajtshme, bankat krijojnë fonde rezervë në nivelin jo më pak se 100% të vlerës kontabël të pasurisë së luajtshme, në rastet kur nuk mund t’i shesin këto pasuri brenda një viti nga data e përfuturit të tyre.

Fondet rezervë njihen si shpenzime ndërsa rimarrja e tyre si e ardhur e periudhës.

j) Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, ndërsa të ardhurat nga interesat e huave nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura, njihen në bazë të mjeteve monetare.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

k) Komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet lindin nga shërbimet financiare të Bankës dhe njihen kur shërbimi respektiv është kryer.

l) Tatimi

Banka përcakton tatimin në fund të periudhës kontabël në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Të ardhurat e tatueshme janë llogaritur duke rregulluar fitimin përpara tatimit për disa të ardhura dhe shpenzime siç kërkohet nga ligji shqiptar.

m) Marrëveshje këmbimi

Kontratat e kursit të këmbimit janë marrëveshje për shkëmbimin e vlerave të caktuara të monedhave me një kurs këmbimi në datën e blerjes ose shitjes. Vlera nominale e këtyre kontratave nuk përfaqëson riskun aktual të tregut ose kredisë të lidhur me këtë produkt.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe
3. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut

Më poshtë paraqiten llojet e ndryshme të rrezikut ndaj të cilave Banka është e ekspozuar si rezultat i aktiviteteve dhe përjasja e ndërmarra për të menaxhuar këto rreziqe.

a) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimet e përgjithshme të aktiviteteve të Bankës dhe në menaxhimin e pozicionimit. Ai përfshin si rrezikun e paaftësisë për të financuar aktivet me maturitet dhe norma të përshtatshme ashtu edhe rrezikun e paaftësisë për të likuiduar një aktiv me një çmim dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm për të përmbushur detyrimet. Fondet krijohen duke përdorur një sërë instrumentash duke përfshirë depozitat dhe kapitalin e paguar. Kjo rrit fleksibilitetin e fondeve, kufizon varësinë nga një burim i vetëm financimesh dhe përgjithsisht ul koston e fondeve. Banka përpiqet për të ruajtur balancën midis vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të shpërndara në kohë. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet e dhura në financime, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vendosura në strategjinë e Bankës.

Më 31 dhjetor 2025 tridhjetë depozituesit jo-bankarë më të mëdhenj përbëjnë 12.30% (2024: 11.76%) të totalit të depozitave nga klientët.

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës sipas grupeve përkatëse të maturitetit bazuar në periudhat e mbetura të maturimit në 31 dhjetor 2025.

Tabela e maturitetit më 31 dhjetor 2025

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Maturiteti papërcaktuar	Gjithsej
Aktivët						
Arka dhe Banka Qendrore	7,411,824	-	-	-	-	7,411,824
Hua dhe paradhënie neto për bankat	2,826,509	-	-	-	-	2,826,509
Bono Thesari	1,420,873	2,345,173	1,797,419	-	-	5,563,465
Letra me vlerë	131,952	873,051	230,501	17,398,001	-	18,633,505
Hua dhe paradhënie neto për klientët	226,431	231,685	1,875,882	35,970,222	-	38,304,220
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	-	558,198	558,198
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	-	-	-	207,827	207,827
Aktive të tjera	-	-	-	-	293,432	293,432
Gjithsej	12,017,589	3,449,909	3,903,802	53,368,223	1,059,457	73,798,980
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të kreditit	1,473,339	73,031	2,656,207	366,978	-	4,569,555
Detyrime ndaj klientëve Marrevëshjet e anasjellta të riblerjes	33,210,242	2,262,704	15,343,468	6,932,331	-	57,748,745
Detyrime të tjera	1,013,985	219,127	-	-	-	1,233,112
Fonde rezervë për huatë standarde dhe në ndjekje	-	-	-	-	1,051,170	1,051,170
Borxhi i varur	-	-	120,357	1,261,881	456,012	456,012
Gjithsej	35,697,566	2,554,862	18,120,032	8,561,190	1,507,182	66,440,832
Hendeku likuiditetit neto	(23,679,977)	895,047	(14,216,230)	44,807,033	(447,725)	7,358,148

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe

3. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

a) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela e maturitetit më 31 dhjetor 2024

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Maturiteti papërcaktuar	Gjithsej
Aktivët						
Arka dhe Banka Qendrore	6,032,758	-	-	-	-	6,032,758
Hua dhe paradhënie neto për bankat	3,244,328	-	-	-	-	3,244,328
Bono Thesari	2,542,360	505,461	685,256	-	-	3,733,077
Letra me vlerë	355,593	1,097,904	819,377	11,950,702	-	14,223,576
Hua dhe paradhënie neto për klientët	270,224	99,342	1,865,902	29,891,083	-	32,126,551
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	-	464,959	464,959
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	-	-	-	128,790	128,790
Aktive të tjera	-	-	-	-	288,368	288,368
Gjithsej	12,445,263	1,702,707	3,370,535	41,841,785	882,117	60,242,407
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të kreditit	468,704	50,000	2,290,339	186,369	-	2,995,412
Detyrime ndaj klientëve	27,569,247	2,528,241	11,578,072	6,105,373	-	47,780,933
Marrevëshjet e anasjellta të riblerjes	383,874	-	-	-	-	383,874
Detyrime të tjera	-	-	-	-	1,021,339	1,021,339
Fonde rezervë për rrezikun statistikor nga huatë standarde dhe në ndjekje	-	-	-	-	435,696	435,696
Borxhi i varur	-	-	2,363	971,685	-	974,048
Gjithsej	28,421,825	2,578,241	13,870,774	7,263,427	1,457,035	53,591,302
Hendeku likuiditetit neto	(15,976,562)	(875,534)	(10,500,239)	34,578,358	(574,918)	6,651,105

b) Rreziku i tregut

Rreziku i normës së interesit

Banka e vlerëson rrezikun e normës së interesit si rreziku që të ardhurat nga interesi gjeneruar nga aktivet që mbartin interesa mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve të papritura të normave të interesit në treg. Veprimtaritë e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normës së interesit në atë nivel që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që paguajnë interes maturohen ose riçmohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e normave të ndryshueshme të aktiveve dhe detyrimeve Banka është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrezikut bazë i cili është diferenca në karakteristikat e riçimit të treguesve me norma të ndryshueshme, siç janë normat e repove të Bankës së Shqipërisë, SOFR dhe EURIBOR. Veç kësaj, efekti aktual varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë nivelin e shlyerjeve që bëhen më përpara ose më vonë sesa data e kontraktuar dhe ndryshimet në normat e interesave brenda periudhës së riçimit dhe ndërmjet monedhave. Në mënyrë që të masë rrezikun nga interesat e aktiviteteve jo-tregtare, Banka e mat impaktin që ka një ndryshim në normat e tregut në të ardhurat neto nga interesat.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe
3. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)
b) Rreziku i tregut (vazhdim)
Rreziku i monedhës

Rreziku i monedhës është rreziku që ka të bëjë me luhatjen e vlerës së drejtë ose flukset e ardhshme të parasë së një instrumenti financiar nga ndryshimet në normën e kursit të këmbimit. Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj dhe emërtimi i instrumentave financiarë në monedhë të huaj.

Nga ekspozimi i transaksioneve të Bankës lindin fitime ose humbje nga këmbimet në monedha të huaja të cilat njihen në humbje ose fitim. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet të Bankës të cilat nuk janë në monedhën raportuese së Bankës.

Më 31 dhjetor 2025 ekspozimi ishte si më poshtë:

	Lekë	EUR	USD	Të tjera	Gjithsej
Aktivet					
Arka dhe Banka Qendrore	2,250,116	4,745,796	370,773	45,139	7,411,824
Hua dhe paradhënie neto për bankat	-	2,354,691	439,671	32,147	2,826,509
Bono thesari	365,768	4,336,146	861,551	-	5,563,465
Letra me vlerë	14,201,480	4,432,025	-	-	18,633,505
Hua dhe paradhënie neto për klientët	17,216,920	20,303,785	783,443	72	38,304,220
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	558,198	-	-	-	558,198
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	207,827	-	-	-	207,827
Aktive të tjera	257,850	34,491	1,079	12	293,432
Gjithsej	35,058,159	36,206,934	2,456,517	77,370	73,798,980
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të kreditit	1,513,338	3,052,722	3,495	-	4,569,555
Detyrime ndaj klientëve	24,327,750	30,954,559	2,389,475	76,961	57,748,745
Marrevëshjet e anasjellta të riblerjes	1,233,112	-	-	-	1,233,112
Detyrime të tjera	561,785	415,205	73,339	841	1,051,170
Fonde rezervë për rrezikun statistikor nga huatë standard dhe në ndjekje	456,012	-	-	-	456,012
Borxhi i varur	-	1,382,238	-	-	1,382,238
Kapitali i paguar	-	1,158,779	-	-	1,158,779
Gjithsej	28,091,997	36,963,503	2,466,309	77,802	67,599,611
Pozicioni neto i monedhës	6,966,162	(756,569)	(9,792)	(432)	6,199,369

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
 në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe

3. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

b) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i monedhës (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2024 ekspozimi ishte si më poshtë:

	Lekë	EUR	USD	Të tjera	Gjithsej
Aktivet					
Arka dhe Banka Qendrore	1,813,842	3,839,383	339,743	39,790	6,032,758
Hua dhe paradhënie neto për bankat	-	2,682,553	471,373	90,402	3,244,328
Bono thesari	619,120	2,644,661	469,296	-	3,733,077
Letra me vlerë	10,049,613	4,173,963	-	-	14,223,576
Hua dhe paradhënie neto për klientët	14,359,211	17,199,615	567,657	68	32,126,551
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	464,959	-	-	-	464,959
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	128,790	-	-	-	128,790
Aktive të tjera	285,104	1,982	1,269	13	288,368
Gjithsej	27,720,639	30,542,157	1,849,338	130,273	60,242,407
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të kreditit	668,022	2,321,108	6,282	-	2,995,412
Detyrime ndaj klientëve	19,717,216	26,179,169	1,755,597	128,951	47,780,933
Marrevëshjet e anasjellta të riblerjes	383,874	-	-	-	383,874
Detyrime të tjera	553,818	393,539	73,091	891	1,021,339
Fonde rezervë për rrezikun statistikor nga huatë standard dhe në ndjekje	435,696	-	-	-	435,696
Borxhi i varur	-	974,048	-	-	974,048
Kapitali i paguar	-	1,175,304	-	-	1,175,304
Gjithsej	21,758,626	31,043,168	1,834,970	129,842	54,766,606
Pozicioni neto i monedhës	5,962,013	(501,011)	14,368	431	5,475,801

Në lidhje me aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj të cilat nuk janë ekonomikisht të mbrojtura (hedged), Banka e menaxhon rrezikun e monedhave të huaja në përputhje me politikat që vendosin kufizime në pozicionimin e monedhës dhe marrëveshjeve.

Kursi i këmbimit i aplikueshëm (Lekë me njësinë e monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
USD	82.46	94.26
EUR	96.77	98.15
GBP	110.76	118.16
CHF	103.97	104.27

3. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë

Banka është subjekt i rrezikut të kredisë nëpërmjet aktivitetit huadhënës dhe në ato raste kur ajo vepron si ndërmjetëse për llogari të klientëve të saj ose palëve të treta ose jep garanci. Në lidhje me këtë, rreziku i kredisë për Bankën lind nga mundësia që palë të ndryshme mund të mos përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut të kredisë ndaj huamarrësve bëhet nëpërmjet analizave të rregullta të aftësisë paguese të huamarrësve dhe përcaktimi i një note klasifikuese. Gjithashtu ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet pjesërisht duke marrë kolaterale dhe garanci.

Ekspozimi kryesor i Bankës ndaj rrezikut të kredisë lind nga huatë dhe paradhëniet. Në këtë kontekst shuma e ekspozimit të kredisë është vlera kontabël e aktiveve në bilanc. Veç kësaj, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për zërat jashtë bilanci nëpërmjet angazhimeve deri në nivelin e kredive dhe garancive të dhëna (shiko shënimi 28) dhe marrëdhënie kontraktuale të qiramarrjes, nga investimet dhe detyrimeve ndaj bankave.

Përqendrimi i rrezikut të kredisë (brenda ose jashtë zërave të bilancit) që lind nga instrumentat financiarë ekziston për palë të tjera kur ato kanë karakteristika të njëjta ekonomike të cilat mund të bëjnë që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet njësoj nga ndryshime në kushtet ekonomike ose faktorë të tjerë. Përqendrimi kryesor i rrezikut të kredisë lind nga lloje të ndryshme klientësh dhe vendodhja e tyre në lidhje me investimet e Bankës, huatë dhe paradhëniet, detyrimet e ardhshme të angazhimeve në nivelin e kredisë dhe garancive të dhëna.

Politika e Bankës është që të kërkojë kolateral të përshtatshëm nga klientë të sigurt përpara disbursimit të kredisë. Garancitë dhe letrat e kreditit janë gjithashtu subjekt i një vlerësimi strikt përpara se të aprovohen. Marrëveshjet specifikojnë limite monetare të detyrimeve të Bankës. Niveli i kolateralit i mbajtur për garancitë dhe letrat e kreditit është të paktën 100%.

Kolaterali për kreditë, garancitë dhe letrat e kreditit është zakonisht në formë monetare, inventar hipotekor, investime të regjistruara ose pasuri të tjera.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 në mijë Lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe

3. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Tabelat më poshtë paraqesin një detajim të ekspozimeve forborne në 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024.

	31 dhjetor 2025									
	Hua të rregullta					Hua me probleme				
	Vlera kontabël bruto	Modifikimi i kontraktuale	Rifinancimi	Hua të rregullta forborne gjithsej	Modifikimi i kontraktuale	Rifinancimi	Hua me probleme forborne gjithsej	Hua forborne gjithsej	Raporti forborne/Hua bruto	
Hua dhe paradhënie për klientët										
Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	20,755,428	2,184,924	101,974	2,286,898	42,443	505,352	547,795	2,834,693	13.66%	
Hua konsumatore	4,610,105	100,246	3,410	103,656	5,459	34,950	40,409	144,065	3.12%	
Hua hipotekore	14,002,539	1,308,334	168,710	1,477,044	27,568	55,734	83,302	1,560,346	11.14%	
Gjithsej	39,368,072	3,593,504	274,094	3,867,598	75,470	596,036	671,506	4,539,104	11.53%	

	31 dhjetor 2024									
	Hua të rregullta					Hua me probleme				
	Vlera kontabël bruto	Modifikimi i kontraktuale	Rifinancimi	Hua të rregullta forborne gjithsej	Modifikimi i kontraktuale	Rifinancimi	Hua me probleme forborne gjithsej	Hua forborne gjithsej	Raporti forborne/Hua bruto	
Hua dhe paradhënie për klientët										
Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	17,667,884	1,771,175	102,346	1,873,521	6,122	407,128	413,250	2,286,771	12.94%	
Hua konsumatore	3,481,994	92,534	5,360	97,894	1,804	31,750	33,554	131,448	3.78%	
Hua hipotekore	11,949,805	985,908	172,843	1,158,751	46,833	91,301	138,134	1,296,885	10.85%	
